



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-11412
Dt: 06.03.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 24 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 06.03.2026 merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Komunal për Kthim, në këtë përbërje:
 1. Armend Behluli - ZKKK-ja - kryesues
 2. Dukagjin Ademi - Arsim
 3. Blerta Qelaj - Shëndetësi
 4. Jozefina Osmani – Punë dhe Mirëqenie Sociale
 5. Albana Bakalli - Shërbime Publike
 6. Rozafat Hoxha - Planifikim dhe Urbanizëm
 7. Merlinda Morina - Gjeodezi, Kadastrës dhe Pronës
 8. Suada Kaxhoshi, Përfaqësuese e MKK-së.
2. Tek projektet bilaterale çështja e pjesëmarrjes dhe roli i përfaqësuesit në Komisionin Komunal për Kthim nga radhët e donatorit rregullohet me marrëveshje në mes MKK-së, Komunës dhe Donatorit.
3. UNHCR-ja ka rol këshillues në Komisionin Komunal për Kthim.
4. Komisioni Komunal për Kthim duhet të reflektoj përbërje etnike dhe gjinore, si dhe do të jetë i hapur për organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare për qëllim të monitorimit. Komisioni është organ rekomandues i cili propozon rastet për vendim tek Komisioni Qendror Shqyrtues në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- ZKKK
- Anëtareve të Komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës

